



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 14 Akti

Nr. 14 Vendimi

Tiranë më 13.04.2018

V E N D I M

Trupa gjyqese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Alma	Faskaj	Kryesuese
Roland	Ilia	Anëtar
Firdes	Shuli	Relatore

me sekretare gjyqësore Znj. Ina Serjanaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. Theo Jacobs, në Tiranë, në datat 11 prill 2018, ora 11:00 dhe 13 prill 2018, ora 09:00, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKT I RIVLERËSIMIT : **Z. Besim Trezhnjeva, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, përfaqësuar nga avokati Fatmir Braka, avokat i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me nr. licence 120.**

OBJEKTI : **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit**

BAZA LIGJORE : **Neni 179/b, dhe nenet A, Ç, D, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;**
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupa gjyquese, pasi dëgjoi relatimin e çështjes nga relatorja Firdes Shuli, subjektin e rivlerësimit dhe përfaqësuesin e tij, avokatin Fatmir Braka, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi dhe bisedoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit Besim Trezhnjeva, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 11.04.2018, kërkoi konfirmimin e tij në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Z. Besim Trezhnjeva është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Apelit në Durrës. Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar “Ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*. Duke qenë se ky subjekt është kandidat për Këshillin e Lartë Gjyqësor, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit me përparësi, sipas nenit 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (me poshtë referuar Komisioni), ka hedhur shortin në datën 30.11.2017, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, Z. Besim Trezhnjeva, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupa gjyquese me nr. 1, e përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Roland Ilia dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

Pas hedhjes së shortit, trupa gjyquese administroi:

1. Raportin e vlerësimit të pasurisë sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (më poshtë referuar “ILDKPKI”);
2. Raportin e vlerësimit të figurës sipas neneve 34 -39 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (më poshtë referuar “DSIK”);

3. Raportin e vlerësimit profesional sipas neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (më poshtë referuar “KLD”).

Me vendimin nr. 1, datë 06.12.2017, trupa gjyquese vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të domosdoshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Besim Trezhnjeva, si dhe caktoi kryesuesin e trupës, komisioneren Alma Faskaj. Në këtë mbledhje, të gjithë anëtarët deklaruan mosqënien në kushtet e konfliktit të interesit.

Më datë 20.12.2017, ka filluar komunikimi në rrugë elektronike me subjektin, sipas nenit 46, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, dhe ai është njoftuar se Komisioni ka filluar ushtrimin e veprimtarisë, me qëllim rivlerësimin kalimtar të tij, në përputhje me nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës dhe sipas ligjit nr. 84/2016.

Me vendimin nr. 2, datë 19.03.2018, trupa gjyquese vendosi:

1. Të përfundojë hetimin paraprak në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, Z. Besim Trezhnjeva.
2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se provat e grumbulluara lidhur me vlerësimin e pasurisë kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, dhe atij i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, bazuar në nenin 52 të këtij ligji, duke i vënë në dispozicion rezultatet paraprake të hetimit.
3. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, duke ushtruar të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarëve, si dhe çdo të drejtë tjetër sipas përcaktimeve në nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016.
4. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi deklarimin e konfliktit të interesit sipas nenit 27, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, si dhe afatin 15-ditor brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

Më datë 03.04.2018, subjekti i rivlerësimit njoftoi në rrugë elektronike se u njoh me materialet e dosjes dhe vuri në dispozicion të Komisionit parashtesë me pretendimet e tij dhe dokumentet shkresore, të cilat u administruan nga trupa gjyquese.

Me vendimin nr. 3, datë 05.04.2018, trupa gjyquese vendosi të ftojë në seancë dëgjimore subjektin e rivlerësimit, Z. Besim Trezhnjeva, në datën 11.04.2018, ora 10:00 paradite, në Pallatin e Kongreseve, kati i 2-të, Tiranë, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në bazë të të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet, që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.”*, trupa gjyquese vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Z. Besim Trezhnjeva, vetëm mbi komponentin e vlerësimit të pasurisë, duke mos përfunduar dhe duke mos marrë në konsideratë hetimet mbi kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

II.1

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI

Në përputhje me nenin 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, ka dërguar raport të hollësishëm¹, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara, prej 531 fletësh.

Nga aktet e ILDKPKI-së rezulton se subjekti ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2004 deri në vitin 2016 dhe në datën 21.01.2017 ka dorëzuar Deklaratën e pasurisë së vlerësimit kalimtar për vetting pranë ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 32/1 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë, ILDKPKI-ja ka konstatuar se :

- deklarimi i subjektit të rivlerësimit nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- subjekti ka kryer fshehje të pasurisë;
- ka kryer deklarim të rremë, si dhe
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

II.2

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pasuritë e subjektit, është kryer proces i plotë hetimor administrativ nga Komisioni, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në:

Deklarimet e subjektit pranë ILDKPKI-së, provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar pranë Komisionit; çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, të kërkuar dhe të marrë në rrugë institucionale nga Komisioni; komunikimin dhe bashkëpunimin me subjektin sipas neneve 46 dhe 48 të ligjit nr. 84/2016, si dhe sugjerime të vëzhguesit ndërkombëtar, për rrethana konkrete në procesin vlerësimit të pasurisë.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në:

¹ Shiko shkresën nr. ***, datë 13.11.2017, te dosja e ILDKPKI-së.

Verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo; të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive, deklarimeve të rremë apo konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 33, pika 5, i ligjit nr. 84/2016.

Procesi i rivlerësimit të pasurisë nga ana e Komisionit është bazuar në sa më poshtë:

1. Në datën 13 gusht 2002 është blerë me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.08.2002, apartament banimi në Tiranë, rruga “****”, me sipërfaqe 71.6 m², me nr. pasurie ***, në çmimin e shitjes 1.400.000 lekë, deklaruar në Deklaratën për Vetting, me burim krijimi nga kursimet familjare

Komisioni ka konstatuar se:

- Kjo pasuri është deklaruar në deklarinimin për vitin 2003, me vlerë 1.400.000 (një milion e katërqind mijë) lekë, me burim krijimi të ardhurat nga puna.
- ZVRPP Tiranë vërteton se kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të subjektit²
- Për këtë pasuri nuk janë konstatuar pasaktësi në deklarime.

2. Në datën 12 nëntor 2003, me kontratën e shitjes nr. *** rep. nr. *** kol., datë 12.11.2003, është blerë apartament banimi i përshtatur për aktivitet privat, në Tiranë, rruga “****”, farmaci “****”, me sipërfaqe 64 m², me nr. pasurie ***, me çmim shitjeje 3.500.000 lekë, deklaruar në deklaratën për vetting, pa u deklaruar burimi i krijimit.

Komisioni ka konstatuar se:

- Kjo pasuri është deklaruar në deklarinimin për vitin 2003, me vlerë 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, me burim krijimi të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes.
- ZVRPP Tiranë vërteton se kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të bashkëshortes së subjektit, Znj. A. T³.
- Duke qenë se në deklaratën për vetting nuk është deklaruar burimi për krijimin e kësaj pasurie, deklarimi është i pasaktë, pasi vjen në kundërshtim me nenin D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, ku parashikohet se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të duhet të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave.

² Shiko shkresën e ZVRPP-së Tiranë, nr. *** prot., datë 20.12.2017, në dosjen e Komisionit.

³ Shiko shkresën e ZVRPP-së Tiranë, nr. *** prot., datë 20.12.2017, në dosjen e Komisionit.

3. Në deklarinimin për vitin 2003 është deklaruar një autoveturë tip “Benz”, e blerë në vlerën 320.000 lekë.

Për arsye se blerjet e dy pasurive të paluajjtshme (***) dhe e autoveturës me targë ***, të përmendura si më sipër, janë bërë jashtë periudhës së vlerësimit (para vitit 2003), analiza financiare nga Komisioni është bërë në total për periudhën 1994-2003, duke i përfshirë të tria pasuritë.

Nga kjo analizë ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar kursimet e krijuara, si dhe shpenzimet në periudhën 1994-2003, në shumën prej 4.661.179 (katër milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekësh, sipas nenit 33, pika 5/b, të ligjit nr. 84/2016, pasqyruar në tabelën më poshtë :

	Vitet 1994-2003
1. Blerë 2 apartamente dhe makinë “Benz”	5.220.000 Lekë
2. Shpenzime shkollimi djali	150.000 Lekë
3. Shpenzime jetese, sipas ILDKPKI-së	1.842.857 Lekë
4. Gjendja e likuiditetit në fund periudhës	3.967.000 Lekë
TOTAL PASURI	11.179.857 Lekë
5. Të ardhura nga pagat subjekti+B/SH	6.518.678 Lekë
Diferenca e pambuluar	-4.661.179 Lekë

Tabelë nr. 1 për periudhën 1994-2003.

4. Në vitin 2004 dhe 2005 nuk është deklaruar dhe nuk rezulton të jetë blerë pasuri.

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat e subjektit, si dhe personave të lidhur me të, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, Z. Besim Trezhnjeva, ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe likuiditetet për këto vite.

5. Në deklarinimin për vitin 2006 është deklaruar blerja një autoveture tip “Benz”, me vlerë 1.200.000 lekë.

Nga hetimi administrativ, bazuar në analizën financiare për vitin 2006, ka rezultuar se subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar likuiditetin në shumën prej 3.655.000 (tre milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekësh, sipas nenit 33, pika 5/b, të ligjit nr. 84/2016, e pasqyruar kjo në mënyrë të përmbledhur në tabelën si më poshtë:

Viti 2006.

1. Gjendja e likuiditetit, 31.12. 2005	7.742.058 Lekë
2. TË ARDHURA	1.492.928 Lekë
3. PASURI NETO	-1.200.000 Lekë
4. SHPENZIME	-755.227 Lekë
5. Gjendja e likuiditetit 31.12.2006	10.934.759 Lekë
Diferenca e pajustificuar	-3.655.000 Lekë

Tabelë nr. 2 për vitin 2006.

6. Në vitin 2007 nuk është deklaruar dhe nuk rezulton të jetë blerë pasuri.

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për të justifikuar kursimet e krijuara, si dhe shpenzimet në shumën prej 1.001.628 (një milion e një mijë e gjashtëqind e njëzet e tetë) lekësh, sipas nenit 33, pika 5/b, të ligjit nr. 84/2016, pasqyruar në tabelën më poshtë :

Viti 2007.

Të ardhura	1.914.920 Lekë
Kursime	2.131.372 Lekë
Shpenzime	785.176 Lekë
Diferenca e pajustificuar	-1.001.628 Lekë

Tabelë nr. 3 për vitin 2007.

7. Më datë 07.10.2008 është blerë shtëpi banimi, me sipërfaqe totale 143,74 m² (sipërfaqe neto 120.5 m²), me adresë në Tiranë, bulevardi “****”, me nr. pasurie *** (sot me numër ***), e blerë në çmimin e shitjes 17.536.280 lekë. Është deklaruar në deklaratën për vetting, me burim krijimi pjesërisht me kredi “Alpha Bank”, në shumën prej 50.000 eurosh, pjesa tjetër e tërhequr në “BKT” nga depozita e bashkëshortes.

Për këtë pasuri nga ILDKPKI-ja është konstatuar:

(i) Deklarim i rremë dhe mungesë burimi financiar në lidhje me shumën prej 50.000 eurosh, në plotësim të vlerës totale të apartamentit me adresë blv. “****”, Tiranë.

(ii) Deklarim i rremë lidhur me kredinë e marrë nga “Alpha Bank” në shumën 50.000 euro, e cila sipas kontratës së kredisë rezulton të jetë marrë për blerje apartamenti ndodhur në Plazh, Durrës, dhe jo në Tiranë, siç është deklaruar nga subjekti.

Komisioni ka konstatuar se:

- Është deklaruar në deklarin periodik për vitin 2008, me burim krijimi kredi nga “Alpha Bank” dhe depozitën e bashkëshortes.
- ZVRPP Tiranë vërteton se kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij, si pasuria me nr. ***, e cila është e njëjtë me pasurinë me nr. ***⁴.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

Noteri, Z. T. K., konfirmon se me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.10.2008⁵, është blerë pasuria me nr. *** (sot ***), me çmimin e shitjes 17.536.280 (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë e dyqind e tetëdhjetë) lekë, të likuiduara tërësisht nga blerësit, Z. Besim Trezhnjeva dhe bashkëshortja Znj. A. T., në favor të shitësit, Z. L. K., jashtë zyrës noteriale, nëpërmjet “BKT”, sipas dokumentit bashkëngjitur kësaj kontrate. Nuk është përmendur në asnjë pjesë të kontratës që shuma prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) eurosh është përfituar me kredi nga “Alpha Bank”, siç subjekti deklaron. Po kështu, nuk ka një dokument bashkëngjitur kontratës nga “BKT”, me të cilin të vërtetohet likuidimi i çmimit të shitjes.

Pas kërkimit të informacionit nga “BKT”, konfirmohet⁶ se në datën 08.10.2008 (një ditë pas lidhjes së kontratës) nga llogaria e bashkëshortes, Znj. A. T., kanë kaluar në llogari të shitësit, Z. L. K., shumat prej 986.977 (nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntë qind e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh dhe 10.673.023 (dhjetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëzet e tre) lekësh, gjithsej 11.660.000 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. Pjesa tjetër e çmimit të shitjes, prej 5.876.280 (pesë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekësh, nuk vërtetohet të jetë paguar te shitësi, Z. L. K., nëpërmjet “BKT”-së, siç subjekti pretendon.

Lidhur me pagimin e pjesës së mbetur të çmimit të shitblerjes dhe burimin financiar për pasurinë apartament banimi në Tiranë, pasuria me nr. *** (sot ***), në deklarinmet e tij⁷ subjekti ka shpjeguar se kredia prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) eurosh e marrë nga “Alpha Bank” është përdorur për blerjen e kësaj pasurie dhe arredimin e saj. Ndërkohë, lidhur me pasurinë apartament banimi në Durrës, e porositur me kontratën e sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.10.2008, kontratë e cila është anuluar me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.12.2008, subjekti ka deklaruar se këto veprime janë bërë fiktive për të mundësuar marrjen e kredisë për blerjen e apartamentit në Tiranë, në blv. “****”.

Lidhur me shumën prej 11.660.000 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh, e cila ka kaluar në llogari të shitësit të pasurisë nr. *** (sot pasuria me numër ***), Zotit

⁴ Shiko shkresën e ZVRPP-së Tiranë, nr. ***, datë 22.12.2017, në dosjen e Komisionit.

⁵ Shiko shkresën nr. ***, datë 11.12.2017, në dosjen e Komisionit.

⁶ Shiko shkresën e “BKT” nr. ***, datë 19.01.2018, në dosjen e Komisionit.

⁷ Shiko përgjigjet për pyetëtorin e datës 06.02.2018, në dosjen e Komisionit.

L. K., pas analizës financiare të viteve 2006 dhe 2007, rezulton se bashkëshortja e subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të biznesit për të krijuar likuiditetin prej 11.660.000 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh, pasi, siç paraqitet nga tabelat më poshtë, gjatë këtyre viteve rezultojnë diferenca të pajustificuara:

Analiza financiare për vitin 2006.

1. Gjendja e likuiditetit 31.12. 2005	7.742.058 Lekë
2. TE ARDHURA	1.492.928 Lekë
3. PASURI NETO	-1.200.000 Lekë
4. SHPENZIME	-755.227 Lekë
5. Gjendja e likuiditetit 31.12.2006	10.934.759 Lekë
Diferenca e pajustificuar	-3.655.000 Lekë

Tabelë nr. 4, analiza financiare për vitin 2006.

Analiza financiare për vitin 2007.

Të ardhura	1.914.920 Lekë
Kursime	2.131.372 Lekë
Shpenzime	785.176 Lekë
Diferenca e pajustificuar	-1.001.628 Lekë

Tabelë nr. 5, analiza financiare për vitin 2007.

“Alpha Bank” konfirmon⁸ se:

1. Në datën 04.11.2008, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij i kanë bërë një propozim Komitetit të Kredisë pranë kësaj banke, për miratimin e një kredie në shumën 50.000 euro, ku rezulton se projekti që do të financohet (qëllimi i huas) është: Blerje apartamenti sipas kontaktës së sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.10.2008, me notere Znj. G. B., e cila ka për objekt apartament banimi 2+1, kati i gjashtë i banimit, me sipërfaqe totale 98 m², me adresë në ***, Durrës.
2. Në datën 13.11.2008, pasi është miratuar kredia në shumën 50.000 euro, është lidhur kontrata e huas me “Alpha Bank”, nr. *** rep., nr. ***, nga notere G. B., me qëllim blerjen e apartamentit në Durrës.
3. Në datën 13.11.2008 është lidhur kontrata e hipotekës me nr. *** rep., nr. *** kol., notere Znj. G. B., sipas së cilës, për shlyerjen e kredisë prej 50.000 eurosh, është vënë si garanci

⁸ Shiko shkresën e “Alpha Bank” me nr. ***, datë 19.12.2017, në dosjen e Komisionit.

hipotekore pasuria e paluajtshme në Tiranë me nr. *** (sot pasuria me nr. ***) e blerë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 07.10.2008, dhe e regjistruar në ZVRPP Tiranë në datën 10.10.2008.

4. Në datën 19.11.2008, sipas dokumentit “Nxjerrje llogarie” nga “Alpha Bank”, është disbursuar kredia prej 50.000 eurosh, në emër të subjektit, Z. Besim Trezhnjeva, dhe po në datën 19.11.2008, shuma prej 49.590 eurosh ka kaluar nga Z. Besim Trezhnjeva te “****” sh.p.k., për blerje apartamenti (në Durrës).

Sa më sipër, rezulton e vërtetuar se:

Kredia prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) eurosh nuk është përdorur për blerjen e pasurisë apartament banimi në Tiranë, me nr. *** (sot pasuria me nr. ***), dhe nuk ka kaluar në llogari të shitësit të saj, Z. L. K., por, është marrë dhe është përdorur për blerjen e një apartamenti në Durrës, dhe ka kaluar në llogari të shitësit të kësaj pasurie, shoqërisë “****” sh.p.k. Si rrjedhojë, deklarimi i subjektit në lidhje me kredinë prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) eurosh si burim krijimi i pasurisë nr. *** (sot pasuria me nr. ***), është deklarim i rremë, parashikuar nga neni 33, pika 5/ç, i ligjit nr. 84/2016.

Nga analiza financiare për vitin 2008, ka rezultuar se ka mungesë burimi të ligjshëm financiar për të justifikuar pasuritë e krijuara në vitin 2008, në shumën prej 5.727.688 (pesë milionë e shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë) lekësh, parashikuar nga neni 33, pika 5/b, i ligjit nr. 84/2016, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Analiza financiare për vitin 2008.

1. Gjendja e likuiditetit, 31.12.2007	13.066.131 Lekë
2. TË ARDHURA	1.900.912 Lekë
3. SHPENZIME	-742.857 Lekë
4. PASURI NETO	-17.536.280 Lekë
Diferenca	-3.312.094 Lekë
5. Gjendja në fund	2.415.594 Lekë
Diferenca e pajustificuar	-5.727.688 Lekë

Tabelë nr. 6, analiza financiare për vitin 2008.

8. Më datë 27.10.2008 është lidhur një kontratë sipërmarrjeje për një apartament banimi në Plazh, Durrës, me sipërfaqe 98 m², me çmim shitjeje 75.000 euro, porositur te shoqëria “****” sh.p.k., e cila është zgjidhur me deklaratë noteriale po në vitin 2008, e padeklaruar nga subjekti.

Edhe pse kjo pasuri nuk është deklaruar në asnjë prej deklarimeve periodike, ILDKPKI-ja ka konstatuar se ka mungesë burimi financiar për likuidimin e shumës prej 25.000 eurosh, në datën 27.10.2008, për shoqërinë “****” sh.p.k., si këst i parë për blerjen e apartamentit.

Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka konstatuar se:

“Alpha Bank” ka dërguar dokumentacionin e plotë⁹, me të cilin vërtetohen të gjitha procedurat për marrjen e kredisë në shumën prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) eurosh, me qëllim blerjen e një apartamenti në Plazh, Durrës, nga ana e subjektit, Z. Besim Trezhnjeva.

Notere G. B. ka vënë në dispozicion të Komisionit¹⁰ kontratën e sipërmarrjes, datë 27.10.2008, nr. *** rep., nr. *** kol., midis sipërmarrësit, Z. A. T., administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., dhe subjektit, Z. Besim Trezhnjeva, për blerjen e një apartamenti banimi 2+1, në katin e gjashtë të banimit, ***, Durrës, dhe deklaratën noteriale të datës 18.12.2008, nr. *** rep., nr. *** kol., që vërteton zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes.

Sipas kontratës së sipërmarrjes, çmimi i shitjes së kësaj pasurie është 75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) euro, nga të cilat 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro janë likuiduar në *cash*, në momentin e lidhjes së kontratës dhe shuma prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) eurosh do të likuidohet me kredinë që do të merret pranë “Alpha Bank”.

Sipas dokumentit “*Nxjerrje llogarie*” nga “Alpha Bank”, rezulton se në datën 19.11.2008 është disbursuar kredia prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) eurosh në emër të subjektit, Z. Besim Trezhnjeva, dhe në datën 19.11.2008, shuma prej 49.590 (dyzet e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) eurosh ka kaluar nga Besim Trezhnjeva te shoqëria “****” sh.p.k., për blerje apartamenti, në Durrës.

Në datën 18.12.2008, sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., kontrata e sipërmarrjes është zgjidhur pa sjellë pasoja juridike-civile për palët. Në deklaratën noteriale nuk vërtetohet mënyra se si palët janë kthyer në gjendjen e mëparshme. Por, pavarësisht kësaj, prezumohet se me zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes, subjektit të rivlerësimit i është kthyer çmimi i blerjes së pasurisë, shuma prej 75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) eurosh, shumë të cilën nuk e ka deklaruar në vitin pasardhës¹¹ te rubrika të *ardhura*, detyrim i parashikuar nga ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

Pavarësisht se subjekti ka pretenduar gjatë procesit të rivlerësimit¹² se kontrata e sipërmarrjes dhe deklarata noteriale për zgjidhjen e saj janë veprime fiktive të kryera prej tij, me qëllim marrjen e një kredie për blerjen e apartamentit në Tiranë, duke mos paraqitur asnjë provë për të vërtetuar këtë pretendim, vërtetohet përmbushja e kushteve të kontratës së sipërmarrjes, si vijon:

⁹ Shiko shkresën “Alpha Bank” nr. *** prot., datë 19.12.2017, në dosjen e Komisionit. (43 fletë, bashkëngjitur)

¹⁰ Shiko shkresën e protokolluar me nr. ***, datë 29.12.2017, në dosjen e Komisionit.

¹¹ Shiko deklarin periodik për vitin 2009 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹² Shiko pyetjet e datës 06.02.2018 dhe përgjigjet e datës 09.02.2018, në dosjen e Komisionit.

- a. Pagimi i shumës prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) eurosh te sipërmarrësi, shoqëria “***” sh.p.k., me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes, deklaruar prej palëve dhe legalizuar te noteri.
- b. Kalimi i shumës prej 49.590 (dyzet e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) eurosh në llogari të shoqërisë “***” sh.p.k., në datën 19.11.2008, dhe jo në llogari të shitësit të pasurisë në Tiranë, Z. L. K.
- c. Mosvërtetimi dhe mosdeklarimi i kthimit të shumës prej 75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) eurosh në llogari të subjektit Besim Trezhnjeva, pas zgjidhjes së kontratës së sipërmarrjes.

Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ është vërtetuar se blerja e apartamentit në Tiranë, pasuria me nr. *** (sot ***), është realizuar në datën 07.10.2008, ndërkohë që kredia prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) eurosh, e pretenduar se është marrë për blerjen e saj, është marrë më vonë, në datën 19.11.2008, pasi është lidhur kontrata e kredisë në datën 13.11.2008.

Veç kësaj, ka rezultuar se si garanci për shlyerjen e kësaj kredie është vënë pasuria me nr. *** (sot pasuria me nr. ***), apartament banimi në Tiranë, për të cilën subjekti pretendon se ka marrë këtë kredi.

Nga të gjitha sa më sipër, trupa gjykuese vlerëson se pretendimi i ngritur nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, se kontrata e sipërmarrjes dhe deklarata për zgjidhjen e saj janë veprime fiktive, nuk rezulton të jetë i vërtetë.

Ndërkohë, nëse ky pretendim do të ishte i vërtetë, trupa gjykuese vlerëson se veprimet fiktive të vetëdeklaruara nga vetë subjekti, të kryera me qëllim përfitimin e kredisë në shumën monetare prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) eurosh për blerjen e një pasurie të paluajtshme (të cilën juridikisht e ka blerë më parë se të kërkonte marrjen e kredisë), deklaramet e rreme se kjo kredi do të përdorej për blerjen e një apartamenti në Durrës, janë veprime që cenojnë figurën dhe etikën e gjyqtarit në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë analizës financiare të kryer nga Komisioni rezulton se, që në momentin e porositjes së pasurisë apartament banimi në Plazh, Durrës, subjekti nuk ka pasur burime financiare për paguar shumën prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) eurosh¹³.

9. Për vitin 2009 nuk është deklaruar dhe nuk rezulton të jetë blerë pasuri.

Nga analiza financiare në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat e subjektit, si dhe personave të lidhur me të, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, Z. Besim Trezhnjeva, ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe likuiditetet për vitin 2009.

10. Në vitin 2010 dhe 2011, subjekti nuk deklaron dhe nuk rezulton të ketë fituar pronësi mbi pasuri të luajtshme ose të paluajtshme.

¹³ Të dhënat e pasqyruara në analizën financiare për vitin 2008, në këtë vendim, fq.10.

Nga analiza financiare për këto vite, rezulton se ka shtim likuiditetesh të pajustificuara në shumën 2.434.953 (dy milionë e katërqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre) lekë, e pasqyruar si në tabelat më poshtë:

Analiza financiare për vitin 2010.

1. Gjendja e likuiditetit, 31.12.2009	3.130.787 Lekë
2. Te ardhura	2.249.899 Lekë
3. Shpenzime	677.560 Lekë
4. Principal Interesa kredi	594.662 Lekë
5. Gjendja e likuiditetit 31/12/2010	5.902.642 Lekë
Diferenca e pajustificuar	-1.794.178 Lekë

Tabelë nr. 7, analiza për vitin 2010.

Analiza financiare për vitin 2011.

1. Gjendja e likuiditetit, 31.12.2010	5.902.642 Lekë
2. Të ardhura	2.474.448 Lekë
3. Shpenzime	700.943 Lekë
4. Principal, interesa, kredi	594.690 Lekë
5. Gjendja e likuiditetit, 31.12.2011	7.722.232 Lekë
Diferenca e pajustificuar	-640.775 Lekë

Tabelë nr. 8, analiza për vitin 2011.

11. Në datën 30.07.2012 është blerë tokë me sipërfaqe 1920 m², me nr. pasurie ***, në ***, Tiranë, e llojit “arë” e blerë me kontratën e shitjes nr. ***, në datën 30.07.2012, në shumën 879.360 lekë, deklaruar në deklaratën për vetting me burim krijimi nga kursimet familjare.

Komisioni ka konstatuar se:

- Kjo pasuri është deklaruar në deklaratimet për vitin 2012, me vlerë 879.360 (tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë, me të ardhura nga pagat.
- ZVRPP Tiranë, konfirmon¹⁴ se kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të subjektit, Z. Besim Trezhnjeva.

¹⁴ Shiko shkresën e ZVRPP-së Tiranë me nr. *** prot., datë 20.12.2017, në dosjen e Komisionit.

➤ Nuk ka pasaktësi në deklaratimet për këtë pasuri.

Nga analiza financiare në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat e subjektit, si dhe personave të lidhur me të, ka rezultuar se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë në shumën prej 490.138 (katërqind e nëntëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekësh, e pasqyruar në tabelën më poshtë:

Analiza financiare për vitin 2012.

1. Gjendja e likuiditetit, 31.12.2011	7.722.232 Lekë
2. TË ARDHURA	2.559.941 Lekë
3. SHPENZIME	-642.857 Lekë
4. PRINCIPAL, INTERESA	-614.768 Lekë
5. PASURI NETO	-879.360 Lekë
6. Gjendja e likuiditetit 31.12.2012	8.635.326 Lekë
Diferenca e pajustificuar	-490.138 Lekë

Tabela nr. 9 për vitin 2012.

12. Në vitin 2013 është blerë makinë tip “Benz”, me vlerë 520.000 lekë, me kontratën nr. ***, datë 13.11.2013.

Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, Z. Besim Trezhnjeva, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e likuiditetit në shumën prej 447.766 (katërqind e dyzet e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekësh, pasqyruar si në tabelën më poshtë:

Analiza financiare për vitin 2013.

1. Gjendja e likuiditetit, 31.12.2012	8.635.326 Lekë
2. TE ARDHURA	2.587.454 Lekë
3. SHPENZIME	-663.889 Lekë
4. PRINCIPAL INTERESA	-602.903 Lekë
5. PASURI NETO	-520.000 Lekë
6. Gjendja e likuiditetit 31/12/2013	9.883.754 Lekë

Diferenca e pajustificuar	-447.766 Lekë
---------------------------	---------------

Tabelë nr. 10 për vitin 2013.

13. Në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit, me kontratën nr. ***, datë 01.10.2014, ka blerë autoveturë, me targë ***, me çmimin 16.000 euro, e deklaruar në deklaratën për vetting. Burim krijimi nga shitja e autoveturës 6.800 euro dhe nga pakësimi i depozitës së bashkëshortes, në shumën 1.300.000 lekë.

Komisioni ka konstatuar se:

- Kjo autoveturë është deklaruar në deklarin periodik për vitin 2014, me burim krijimi nga shitja e një autoveture në çmimin 6800 (gjashtë mijë e tetëqind) euro dhe pakësim i depozitës së bashkëshortes në shumën 1.300.000 (një milion e treqind mijë) lekë.
- DPSHTRR konfirmon¹⁵ se subjekti e ka të regjistruar në emër të tij këtë pasuri.
- Nuk ka pasaktësi në deklarime.

Pas analizës financiare të vitit 2014, rezulton se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive në vitin 2014, në shumën prej 75.654 (shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër) lekë, sipas tabelës më poshtë:

Analiza financiare për vitin 2014.

7. Gjendja e likuiditetit, 31.12.2013	9.883.754 Lekë
8. TË ARDHURA	2.640.587 Lekë
9. SHPENZIME	-922.857 Lekë
10. PRINCIPAL INTERESA	-587.902 Lekë
11. PASURI NETO	-1.289.012 Lekë
12. Gjendja e likuiditetit, 31.12.2014	9.800.224 Lekë
Diferenca e pajustificuar	-75,654 Lekë

Tabelë nr. 11 për vitin 2014.

14. Në vitet 2015-2016 subjekti nuk ka deklaruar dhe nuk rezulton të ketë blerë pasuri.

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, Z. Besim Trezhnjeva, nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive në vitet 2015 dhe 2016.

¹⁵ Shiko shkresën e DPSHTRR-së nr. ***, datë 19.12.2017, dhe shkresën nr. ***, datë 21.02.2018, në dosjen e Komisionit.

15. Lidhur me detyrimet financiare, subjekti ka deklaruar kredi “Alpha Bank”, marrë për blerje shtëpie, deklaruar në deklaratën për vetting.

Për këtë detyrim, Komisioni ka konstatuar se:

- Kjo kredi është deklaruar nga subjekti në deklarin periodik për vitin 2008.
- Subjekti ka deklaruar shumat përkatëse të pagimit të kredisë në deklaratat periodike vjetore, duke filluar që nga deklarimi për vitin 2008.
- “Alpha Bank” ka konfirmuar¹⁶ gjendjen e kredisë në datën 16.01.2017 në shumën prej 35,555.36 eurosh.
- Deklarimet për këtë kredi janë të sakta.

16. Është deklaruar për vetting llogari rrjedhëse për pagën “Raiffeisen Bank”, në favor të subjektit të rivlerësimit, me nr. 0000771171, pa u deklaruar shuma e likuiditetit.

Komisioni ka konstatuar se:

- Është deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2016, llogari rrjedhëse për pagën, me gjendje në datë 31.12.2016, në shumën 359.942 (treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e dyzet e dy) lekë.
- Në deklaratën për vetting është deklaruar numri i llogarisë, por nuk është deklaruar shuma prej 481.430 (katërqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e tridhjetë) lekësh gjendje në datën 20.01.2017¹⁷.
- Për këtë likuiditet ka deklarim të pasaktë, pasi në deklaratën për vetting nuk është deklaruar vlera e likuiditetit llogari rrjedhëse në shumën 481.341 (katërqind e tetëdhjetë e një mijë e treqind e dyzet e një) lekë, sipas nenit 3, pika 11, shtojca 2 “Formulari i deklarimit të pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.

17. Është deklaruar në deklaratën për vetting llogari bankare në “BKT”, gjendja e datës 16.01.2017, me vlerë 344.003 lekë, në emër të bashkëshortes, Znj. A. T.

Komisioni konstatoi se:

- BKT¹⁸ vërteton gjendjen e llogarisë me nr. ***, në datën 16.01.2017, me vlerë 344.003 (treqind e dyzet e katër mijë e tre) lekë. Deklarimi është i saktë.

¹⁶ Shiko shkresat e “Alpha Bank” nr. *** prot., datë 19.12.2017, dhe nr. *** prot., datë 12.02.2018, në dosjen e Komisionit.

¹⁷ Shiko shkresën e “Raiffeisen Bank”, me nr. ***, datë 15.12.2017, në dosjen e Komisionit.

¹⁸ Shiko shkresën nr. ***, datë 19.01.2018, në dosjen e Komisionit.

18. Është deklaruar për vetting llogari rrjedhëse në “Credins Bank”, në shumën 218.449 lekë, në emër të bashkëshortes, Znj. A. T.

Komisioni konstatoi se:

- “Credins Bank”¹⁹ vërteton gjendjen e llogarisë me numër ***, në emër të Znj. A. T., në datën 20.01.2017, në shumën 218.499 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë. Deklarimi është i saktë.

19. Në deklaratën për vetting është deklaruar llogari bankare në “BKT”, me gjendje në datën 16.01.2017 në shumën 6.105.063 lekë, në emër të bashkëshortes, Znj. A. T.

Komisioni konstatoi se:

- “BKT”²⁰ vërteton se në datën 20.01.2017, Znj. A. T., ka gjendje llogarie në shumën 6.105.063 (gjashtë milionë e njëqind e pesë mijë e gjashtëdhjetë e tre) lekë. Deklarimi është i saktë.

20. Subjekti ka deklaruar në deklaratën për vetting të ardhura të bashkëshortes, Znj. A. T., për periudhën 2005-2016, në shumën 22.500.000 lekë.

Për këtë likuiditet ILDKPKI-ja ka konstatuar se të ardhurat e deklaruara nga bashkëshortja e subjektit, Znj. A. T., si fitim nga aktiviteti “Farmaci”, për periudhën 2005-2016, janë në shumën prej 12.175.486 (dymbëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekësh dhe jo 22.500.000 (njëzet e dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

Gjatë hetimit administrativ, për të verifikuar këto të ardhura Komisioni mori në shqyrtim dokumentet shkresore të marra nga institucionet kompetente tatimore²¹, si dhe analizoi deklaratimet ndër vite të subjektit. Pas një analize të detajuar financiare, si në tabelat më sipër në këtë vendim, trupa gjyqësore konstatoi se të ardhurat neto të Znj. A. T., nga aktiviteti privat si farmacistë, për periudhën 2003-2016, janë 12.844.341 (dymbëdhjetë milionë e tetëqind e dyzet e katër mijë e treqind e dyzet e një) lekë.

Komisioni ka filluar përllogaritjet që nga viti 2003, kur subjekti ka pasur detyrimin për deklarimin e pasurive. Për vitet 2003 dhe 2004, të ardhurat nga aktiviteti privat si farmacistë janë 1.322.500 (një milion e treqind e njëzet e dy mijë e pesëqind) lekë. Analiza financiare për llogaritjen e të ardhurave për këtë periudhë është mbështetur në llogaritjet alternative, në bazë të të dhënave që

¹⁹ Shiko shkresën e “Credins Bank” nr. ***, datë 21.12.2017, në dosjen e Komisionit.

²⁰ Shiko shkresën e “BKT” nr. ***, datë 19.01.2018, në dosjen e Komisionit.

²¹ Shiko shkresën nr. ***, datë 20.07.2017 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë; shkresën nr. ***, datë 09.11.2017, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë; shkresën nr. ***, datë 30.06.2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Tiranë; shkresën nr. ***, datë 02.08.2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë.

Komisioni disponon²², pasi është konstatuar në këto dokumente se për vitet 2003 dhe 2004, institucioni i tatimeve ka konfirmuar xhiron pa përcaktuar fitimin.

Sa më sipër, rezulton se në deklaratën për vetting ka deklarim të pasaktë dhe në kundërshtim me nenin 33, pika 5/a, të ligjit nr. 84/2016, të të ardhurave të Znj. A. T., për periudhën 2003-2016, pasi këto të ardhura janë deklaruar në shumën 22.500.000 (njëzet e dy milionë e pesëqind mijë) lekë, ndërkohë që rezulton që ato të kenë qenë në shumën 12.844.341 (dymbëdhjetë milionë e tetëqind e dyzet e katër mijë e treqind e dyzet e një) lekë.

21. Në deklaratën për vetting, vajza e subjektit, Znj. O. T., nuk ka deklaruar një llogari bankare pranë “Credins Bank”.

Komisioni konstatoi se:

- ILDKPKI ka përmendur në raport se llogaria e pagës së vajzës së subjektit të rivlerësimit, Znj. O. T., me gjendje prej 148.226 (njëqind e dyzet e tetë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë) lekësh, në datën 21.01.2017, nuk është deklaruar.
- “Credins Bank”²³ vërteton se shtetasja O. T. ka llogari page në gjendje, datë 21.01.2017, në shumën 148.226 (njëqind e dyzet e tetë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë) lekë.
- Ka mosdeklarim të shumës prej 148.226 (njëqind e dyzet e tetë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë) lekësh, e konsideruar si fshehje pasurie, sipas nenit 33, pika 5/c, të ligjit nr. 84/2016.

22. Subjekti deklaroi për herë të fundit ndryshimin e gjendjes *cash* në vitin 2010. Në deklaratën për vetting nuk ka gjendje *cash* të deklaruar.

Lidhur me likuiditetet në *cash*, Komisioni konfirmon se subjekti:

- Nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* pas vitit 2010 deri në deklaratën për vetting, ku rezulton të mos jetë deklaruar likuiditeti - gjendje *cash*.
- Në vitin 2010, ai deklaroi shtesë prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh dhe gjendja *cash* në fund të këtij viti është në shumën prej 3.194.050 (tre milionë e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëdhjetë) lekësh, duke përfshirë dhe gjendjen *cash* të viteve më parë.
- Në deklarinimin e vitit 2011 e në vazhdim nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për të deklaruar shtesat apo pakësimet e gjendjes *cash*. Si rrjedhim, gjendja *cash* në momentin e deklarimit për vettingun, rezulton të jetë në shumën 3.194.050 (tre milionë e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëdhjetë) lekë.
- Në deklaratën për vetting subjekti nuk deklaroi gjendje *cash*.

²² Shiko shkresat në *footnote* nr. 21.

²³ Shiko shkresën “Credins Bank”, me nr. ***1, datë 27.12.2017, në dosjen e Komisionit.

Lidhur me likuiditetet *cash*, subjekti ka deklarim të pasaktë në deklaratën për vetting, pasi ai ka pasur detyrimin për t'i deklaruar ato sipas nenit 3, pika 11, shtojca 2 “Formulari i deklarimit të pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.

II.3 Metodologjia e përdorur nga Komisioni, për analizën financiare

Gjatë analizës financiare²⁴ trupa gjyquese është bazuar në:

1. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga “Raiffeisen Bank”²⁵, “Intesa Sanpaolo Bank”²⁶, “Credins Bank”²⁷, “BKT”²⁸, “Alpha Bank”²⁹, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti³⁰.
2. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:
 - (i) Të ardhurat nga pagat e subjektit në Gjykatën Lezhë³¹, të ardhurat nga pagat e subjektit në Gjykatën e Apelit Shkodër³², të ardhura nga shpërblimet si anëtar i KLD-së³³, të ardhura nga pagat në Gjykatën e Apelit Durrës³⁴.
 - (ii) Të ardhura nga fitimi neto i biznesit “Farmaci” të bashkëshortes së subjektit, vërtetuar me shkresat e ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve³⁵.
 - (iii) Të ardhura të vajzës së subjektit, Znj. O. T., pranë “BKT”³⁶ dhe pranë “Credins Bank”³⁷.
3. Shpenzimet, ku përfshihen :
 - (i) Shpenzimet e jetesës bazuar në llogaritjet e ILDKPKI-së.³⁸
 - (ii) Shpenzime shkollimi të djalit bazuar në deklaratimet e subjektit.³⁹

²⁴ Shiko 13 tabelat në këtë vendim.

²⁵ Shiko shkresën nr. ***, datë 15.12.2017, në dosjen e Komisionit.

²⁶ Shiko shkresën nr. ***, datë 18.12.2017, në dosjen e Komisionit.

²⁷ Shiko shkresën nr. ***, datë 27.12.2017, në dosjen e Komisionit.

²⁸ Shiko shkresën ***, datë 27.12.2017, në dosjen e Komisionit.

²⁹ Shiko shkresën nr. ***, datë 19.12.2017, dhe nr. 4047, datë 12.02.2018, në dosjen e Komisionit.

³⁰ Shiko deklaratimet periodike të çdo viti, në dosjen e ILDKPKI-së.

³¹ Shiko vërtetimin nr. *** prot., datë 17.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

³² Shiko vërtetimin nr. *** prot., datë 13.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

³³ Shiko vërtetimin nr. *** prot., datë 17.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁴ Shiko vërtetimin nr. *** prot., datë 16.01.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁵ Shiko shkresat nr. ***, datë 21.07.2017 dhe 131/32 a, datë 09.11.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁶ Shiko shkresën nr. *** prot., datë 05.07.2017 të “BKT”, në dosjen e ILDKPKI-së dhe nr. ***, datë 27.12.2017, të “BKT”, në dosjen e Komisionit.

³⁷ Shiko shkresën nr. *** prot., datë 27.12.2017.

³⁸ Shiko raportin përfundimtar të ILDKPKI-së, fq.13.

³⁹ Shiko deklaratimet periodike e viteve 2003-2008 dhe 2014-2016

(iii) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS⁴⁰. Për përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si bazë shpenzimet mesatare të udhëtimeve sipas linjave ajrore, duke filluar nga 180 euro për udhëtim për linjat *low cost* deri në 300 euro për udhëtim për linjat më të gjata. Në rastet kur ka informacion për destinacionet e largëta, shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur, duke parë në internet çmimet mesatare të destinacionit përkatës. Ndërsa për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi.

4. Principalin dhe interesat e paguara për kredinë, të marra nga dokumentet e ardhura nga “Alpha Bank”⁴¹.
5. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive.⁴²

III.REZULTATET E HETIMIT PARAPRAK ADMINISTRATIV LIDHUR ME VLERËSIMIN E PASURIVE

Në përfundim të hetimeve paraprake administrative në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet si më sipër, të kryera sipas neneve 44, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016 deri në datën 23.03.2018, për subjektin e rivlerësimit, Z. Besim Trezhnjeva, në deklaratën për vetting, kanë rezultuar:

1. Deklarime të pasakta që vijnë në kundërshtim me nenin 33, pika 5/a, të ligjit nr. 84/2016 në lidhje me:
 - a. burimin e krijimit të pasurisë nr. *** (farmaci e bashkëshortes);
 - b. të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga ushtrimi i aktivitetit privat si farmacistë,
 - c. likuiditetin në shumën prej 481.341 lekësh në “Raiffeisen Bank” në emër të subjektit,
 - d. likuiditetet në *cash*.
2. Mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë në vlerën prej 20.133.368 (njëzet milionë e njëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekësh, parashikuar nga neni 33, pika 5/b, i ligjit nr. 84/2016.
3. Deklarim i rremë në lidhje me kredinë prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) eurosh të marrë nga “Alpha Bank”, si pjesë e çmimit të blerjes së pasurisë me nr. *** (sot pasuria me nr. ***), pasi kjo nuk është vërtetuar gjatë hetimit administrativ, përkundrazi, është vërtetuar se kjo shumë ka kaluar në llogari të shoqërisë “***” sh.p.k., parashikuar nga neni 33, pika 5/ç, i ligjit nr. 84/2016.
4. Mosdeklarim i shumës prej 148.226 (njëqind e dyzet e tetë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë) lekësh, llogari e vajzës, Znj. O. T., pranë “Credins Bank”, e cila edhe pse vlerësohet nga

⁴⁰ Shiko shkresën nr. ***, datë 15.12.2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në dosjen e Komisionit dhe të dhënat e nxjerra nga sistemi TIMS në dosjen e Komisionit.

⁴¹ Shiko shkresën e “Alpha Bank”, me nr. ***, datë 19.12.2017 dhe nr. ***, datë 12.02.2018, në dosjen e Komisionit.

⁴² Shiko kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme bashkëngjitur shkresës së ZVRPP-së Tiranë me numër prot. ***, datë 20.12.2017, si dhe kontrat e shitjeve të automjeteve bashkëngjitur shkresave të DPSHTRR Tiranë me nr. ***, datë 19.12.2017 dhe nr. ***, datë 21.02.2018, në dosjen e Komisionit.

trupa si një shumë jo e konsiderueshme, parashikohet si fshehje pasurie nga neni 33, pika 5/c, e ligjit nr. 84/2016.

5. Në rezultatet paraprake të hetimit është konstatuar gjithashtu se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë tërësisht bashkëpunues me Komisionin gjatë komunikimit elektronik, sipas nenit 46, pika 1, të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pyetësin e parë të dërguar me *email* në adresë të subjektit në datën 20.12.2017, Komisioni është njoftuar në rrugë elektronike se *email-i* është nisur në datën 20.12.2017, ora 4:36:48 PM, dhe është lexuar nga subjekti po në datën 20.12.2017, në orën 5:34:29 PM. Ndërkohë, subjekti ka deklaruar se *për pyetësin e dërguar me email në datën 20.12.2017 jam vënë në dijeni me vonesë*, fakt i cili nuk rezulton të jetë i vërtetë.⁴³

Nisur nga rezultatet si më sipër, deri në këtë fazë të hetimit administrativ, trupa gjykuese ka vlerësuar se kriteri i pasurisë është i mjaftueshëm për procesin e rivlerësimit të subjektit, referuar nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit vendimi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit merret në bazë të një ose disa prej kritereve.

Për këtë arsye, me vendimin nr. 2, datë 19.03.2018, pasi është konstatuar se provat e mbledhura gjatë hetimit paraprak administrativ kanë nivelin e provueshmërisë, trupa gjykuese ka vendosur të ndërpresë hetimin administrativ lidhur me vlerësimin e pasurisë dhe sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 i ka kaluar subjektit barrën e provës, duke i vënë në dispozicion rezultatet paraprake të hetimit në lidhje me vlerësimin e pasurisë deri në këtë fazë.

IV. NË LIDHJE ME PARASHTRESËN E SUBJEKTIT

Pasi ka marrë në dorëzim dokumentet e dosjes, në ushtrim të së drejtës së barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, në datën 03.04.2018, subjekti ka paraqitur pranë Komisionit dokumentet si më poshtë:

1. **Parashtresë**, me pretendimet e tij,
2. **Raport i auditit të pavarur** nga një shoqëri private auditimi, i titulluar: “Për qëllime të veçanta mbi auditimin e dokumenteve mbi të cilat është përgatitur raporti paraprak i hetimit administrativ dhe analiza financiare nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit”.
3. **Nxjerrje llogarie** të bashkëshortes nga Banka Kombëtare Tregtare për periudhën 22.10.2001-28.12.2016, të cilat janë kërkuar nga ky institucion dhe janë administruar nga trupa gjykuese, gjatë hetimit administrativ.

Në analizë të pretendimeve të ngritura në parashtresë, trupa gjykuese ka konstatuar dhe ka vlerësuar si vijon:

⁴³ Shiko email-in e dërguar në datën 20.12.2017 dhe përgjigjen me e-mail të datës 12.02.2018, si dhe konfirmimet e sistemit elektronik të printuara, në dosjen e Komisionit.

- a. Subjekti pretendon se, *gjatë analizës financiare nuk është marrë në konsideratë periudha para vitit 1994, kur ai ka qënë gjyqtar në Gjykatën e Tropojës, si dhe bashkëshortja e tij ka ushtruar aktivitetin si farmacistë. Ai pretendon që të ketë pasur gjëndje rreth 2.500.000 lekë në vitin 1993, e cila nuk i është marrë në konsideratë gjatë analizës financiare nga Komisioni për periudhën 1994-2003.*

Lidhur me këtë pretendim, trupa gjyquese vlerëson se është i pambështetur në dokumente. Veç kësaj, nga deklarimi për vitin 2003, kur subjektit i ka lindur detyrimi për deklarim të pasurive, nuk rezulton që ai të ketë pasur dhe të ketë deklaruar kursime për të vërtetuar këtë likuiditet, deklarime të cilat do të shërbenin si provë sipas parashikimit të nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

- b. Subjekti i rivlerësimit është shprehur se *Komisioni, në vlerësimet e tij i është referuar qartësisht ILDKPKI-së, institucion i cili, sipas tij, për të njëjtën periudhë, për të njëjtin objekt vlerësimi, ka bërë vlerësime të ndryshme. Gjithashtu, subjekti pretendon se vlerësimi i pasurive sipas deklarimeve të tij ndër vite, deri në fund të vitit 2013, duhet të konsiderohet si “gjë e gjykuar”.*

Lidhur me këtë pretendim, trupa gjyquese vlerëson se, ILDKPKI-ja është institucioni të cilin ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, e ka përcaktuar si organ përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive, nëpërmjet Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

Komisioni është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve *ex officio*, bazuar në nenin 179/6, paragrafi 5, i ligjit nr. 76, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, si dhe në nenin 3, pika 5, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sa më sipër, lidhur me kompetencat e Komisionit, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017 (pika 27) ka përcaktuar, ndër të tjera, se: “Edhe pse ligji ka parashikuar në mënyrë më të detajuar kompetencat e ILDKPKI-së dhe rolin e saj konkret në këtë proces, nuk rezulton se bien ndesh me kompetencën kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe as e cenon në thelb atë”.

Për këtë arsye, Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur, çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Pretendimi i subjektit se jemi përpara “*gjësë së gjykuar*” është tërësisht i pabazuar në ligj.

- c. Subjekti i rivlerësimit është shprehur se, *sipas nenit 61, paragrafi i parë, të ligjit nr. 84/2016, kriter parësor për shkarkimin nga detyra është se subjekti i rivlerësimit nuk duhet të ketë më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë rivlerësimit të pasurisë. Sipas gjetjeve të Komisionit, subjekti ka një diferencë të pajustificuar prej rreth 20 milionë lekësh, e cila rezulton më pak se totali i të ardhurave vetëm të subjektit, pa përfshirë këtu personat e lidhur.*

Lidhur me këtë pretendim, trupa gjykuese vlerëson se në asnjë rast nuk i është bërë me dije subjektit fakti se ai duhet të shkarkohet nga detyra për shkak të dyfishit të pasurisë.

Gjithashtu, vlen të theksohet se dyfishi i pasurisë është një nga shkaqet ligjore për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, parashikuar nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016, i cili sanksionon edhe katër raste të tjera për marrjen e kësaj mase.

d. Subjekti i rivlerësimit është shprehur se *kredia e marrë në bankë prej 50.000 eurosh nuk është deklarim i rremë dhe se nuk ndodhet përpara mungesës së burimeve financiare*. Gjithashtu, është shprehur se, *pa të drejtë Komisioni ka konkluduar për veprim juridik të pavlefshëm, në rastin e kontratës së sipërmarrjes*.

Lidhur me këtë pretendim, trupa gjykuese vlerëson se:

- Është provuar me dokumente shkresore gjatë hetimit administrativ se kredia e marrë në shumën prej 50.000 eurosh nga “Alpha Bank” nuk është përdorur për blerjen e apartamentit në Tiranë, siç ka deklaruar subjekti, po ka kaluar në llogarinë e “****” sh.p.k.
- Veç kësaj, subjekti ka deklaruar në përgjegjësinë e tij se kontrata e sipërmarrjes dhe deklarata noteriale për zgjidhjen e saj janë bërë fiktive, për të mundësuar marrjen e kredisë për blerjen e apartamentit, ndodhur në bulevardin “****”, Tiranë. Në rezultatet paraprake të hetimit, subjektit i është komunikuar vetëm konstatimi se veprimet fiktive të vetëdeklaruar prej tij, vijnë në kundërshtim me figurën e një gjyqtari në Republikën e Shqipërisë, gjë që sjell cënimin e besimit të publiku. Komisioni, nuk ka kompetencë ligjore dhe nuk ka kryer gjatë hetimit administrativ paraprak asnjë veprim lidhur me vërtetimin e vlefshmërisë ose të pavlefshmërisë së kontratës së sipërmarrjes, sikurse subjekti pretendon.

e. Subjekti i rivlerësimit është shprehur se *shuma e cituar nga Komisioni, si e fshehur në emër të vajzës, në vlerën 148.226 lekë, përfaqëson të ardhurat neto nga paga prej punëdhënësit publik dhe se kjo është një shumë modeste*.

Lidhur me këtë pretendim, trupa gjykuese vlerëson se subjekti dhe personat e lidhur kanë detyrimin të deklarojnë të ardhurat neto si burime të ligjshme dhe gjendjet e llogarive bankare deri në periudhën e deklarimit. Në asnjë rast nuk është përmendur se këto të ardhura nuk janë nga burime të ligjshme, por ligji përcakton detyrimin për t’i deklaruar. Mosdeklarimi i çfarëdolloj shume, konsiderohet nga ligji si fshehje pasurie, sipas nenit 33, pika 5/c, të ligjit nr. 84/2016.

f. Lidhur me pretendimin për të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti privat si farmacistë, trupa gjykuese ka arritur në konkluzionin se ky pretendim është i pabazuar në prova dhe në ligj, duke ndjekur hapat e mëposhtëm :

Gjatë hetimit administrativ dhe pas një analize të thelluar financiare, për periudhën nga viti 2003 deri në vitin 2016, mbështetur në informacionet e dokumentuara dhe të marra në rrugë ligjore nga institucionet kompetente, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, Komisioni ka arritur në këto përfundime:

1. Të ardhurat neto të bashkëshortes së subjektit, Znj. A. T., nga aktiviteti privat si farmacistë, janë 12.844.341 lekë, dhe jo në shumën e deklaruar prej 22.500.000 lekësh.

2. Nga të dhënat në total, për të gjithë periudhën e deklaramit, 2003-2016, si më poshtë:

Pasuri total	43.774.431 lekë
<u>Detyrime</u>	<u>4.256.887 lekë</u>
Pasuri neto	39.517.545 lekë
<u>Shpenzime</u>	<u>14.318.043 lekë</u>
Pasuri + shpenzime	53.835.587 lekë
Të ardhura	33.702.219 lekë

rezultojn një diferencë e pajustificuar në shumën prej 20.133.368 lekësh. Në mënyrë të përbledhur, analiza financiare është pasqyruar në tabelën si më poshtë:

VITET	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
TE ARDHURA	1 464 702	2 422 589	3 780 249	1 492 928	1 914 920	1 900 912	2 675 581	2 249 899	2 474 448	2 559 941	2 587 454	2 640 587	2 627 930	2 910 079
SHPENZIME	792 857	1 079 986	932 794	755 227	785 176	742 857	1 040 924	1 033 746	1 058 034	1 017 586	1 025 911	1 517 302	1 437 331	1 098 311
PASURI NETO	7 467 516	1 123 059	2 651 483	4 392 701	2 131 372	9 965 306	950 850	3 010 331	2 057 189	2 032 494	2 009 309	1 198 939	184 158	342 838
PASURI NETO+SHPENZIME	8 260 373	2 203 045	3 584 277	5 147 928	2 916 548	10 708 163	1 991 775	4 044 077	3 115 223	3 050 080	3 035 219	2 716 241	1 621 490	1 441 149
Diferenca	-6 795 671	219 544	195 972	-3 655 000	-1 001 628	-8 807 251	683 806	-1 794 178	-640 775	-490 139	-447 765	-75 654	1 006 440	1 468 930

Tabelë nr. 12, përbledhje 2003-2016.

Pasi këto dy konstatime i janë njoftuar subjektit, ai ka paraqitur parashtresën e tij, sipas së cilës pretendon se diferenca prej 20.133.368 lekësh ka ardhur si rezultat i mosmarrjes në konsideratë të të ardhurave të bashkëshortes, Znj. A. T., nga ushtrimi i aktivitetit privat si farmacistë për periudhën 2001 - 2016, në shumën rreth 28.792.986 lekë. Për të vërtetuar këto pretendime, subjekti ka paraqitur një raport auditimi nga shoqëria audituese “****” sh.p.k., të datës 31.03.2008.

Duke iu referuar këtij raporti, subjekti pretendon se analiza financiare e kryer nga ana e Komisionit ka anomali materiale dhe se Komisioni nuk ka bërë një përllogaritje të saktë të të ardhurave të bashkëshortes, Znj. A. T. Konkretisht, sipas tij, nuk janë përllogaritur vlerat e rimbursuara nga shteti për bashkëshorten e tij, si vijojnë:

Për vitin 2004, vlera e rimbursimit është 2.982.096 lekë; për vitin 2005 është 2.201.959 lekë; për vitin 2006 është 1.811.012 lekë; për vitin 2007 është 635.632 lekë; për vitin 2008 po kështu; për vitin 2009 është 1.706.657 lekë, ndërkohë që për vitet 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014, vlera e rimbursimit arrin përkatësisht në 1.893.277 lekë, 1.878.031 lekë, 1.755.848 lekë, 2.415.685 lekë dhe 1.902.141 lekë.

Në total, sipas subjektit, për periudhën 2001-2016 janë realizuar të ardhura nga farmacia “****” në vlerën e përafërt 26.000.000 lekë, ndërsa njëra prej llogaritjeve alternative e nxjerr vlerën e të ardhurave prej 28.792.968 lekësh.

Me vënien në dijeni të këtyre pretendimeve, trupa gjyquese, duke marrë në konsideratë kërkesën e subjektit, ka analizuar raportin e auditit të pavarur të datës 31.03.2018, i paraqitur si provë prej tij, dhe ka rishqyrtuar konkluzionet e rezultateve paraprake të hetimit lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit. Në përfundim të këtij procesi rishqyrtimi, Komisioni vëren se konkluzionet e raportit të auditit të pavarur, “****” sh.p.k., dhe pretendimet e subjektit lidhur me të ardhurat e bashkëshortes, janë krejtësisht të pabazuara, duke arsyetuar si më poshtë:

Sipas ligjit nr. 9928, datë 29.04.2004, “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, raporti i auditimit të pavarur të një aktiviteti privat, duhet të bazohet në dokumente ligjore, që vërtetojnë të ardhurat dhe shpenzimet e biznesit për periudhën e auditimit.

Raporti i auditit të pavarur “****” sh.p.k., nuk është bazuar në dokumente ligjore të institucionit kompetent, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Në kundërshtim me ligjin, ky raport është bazuar vetëm në të ardhurat nga rimbursimet e shtetit për farmacinë e bashkëshortes, Znj. A. T., ndërkohë që këto të ardhura nuk janë fitime neto. Ndërsa analiza financiare e Komisionit është bazuar në dokumente zyrtare të dhëna nga institucionet kompetente⁴⁴ dhe të gjeneruara nga deklarimet e subjektit ndër vite.

Për sa u përket fakteve dhe provave shkresore që subjekti pretendon se ka paraqitur, Komisioni konstatoi se të vetmet dokumente shtesë të paraqitura prej tij janë gjendjet e llogarive bankare të bashkëshortes pranë “BKT” për periudhën 22.10.2001-28.12.2016 dhe asnjë dokument apo fakt tjetër. Këto gjendje llogarie bankare janë administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe janë marrë në konsideratë gjatë analizës financiare⁴⁵. Subjekti ka paraqitur si provë të re vetëm raportin e auditit të pavarur “****” sh.p.k., i cili, siç rezulton edhe nga titullimi i tij, është bërë “PËR QËLLIME TË VEÇANTA MBI AUDITIMIN E DOKUMENTEVE MBI TË CILAT ËSHTË PËRGATITUR RAPORTI PARAPRAK I HETIMIT ADMINISTRATIV, SI DHE ANALIZA FINANCIARE NGA ILDKPKI DHE KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT”, dhe nuk është bazuar në asnjë dokument tjetër ligjor, të ndryshëm nga ato të administruara nga trupa gjyqesore.

Për sa u përket argumenteve, i vetmi argument që paraqet subjekti, është se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti privat si farmacistë për periudhën 2001-2016, në total të llogaritura një herë në shumën 26.000.000 lekë, dhe një herë tjetër në shumën 28.792.986 lekë. Ndërkohë, deklarimet e subjektit ndër vite lidhur me të ardhurat e Znj. A. T., nuk përkohjnë me të ardhurat e pretenduara në raportin e auditit të pavarur.

Sipas subjektit, këto të ardhura përbëhen nga shumat që i janë xhiruar Znj. A. T., nga Drejtoria e Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor në llogarinë e farmacisë së saj. Sipas ligjit nr. 9928, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, shuma e rimbursuar nga shteti për çdo vit nuk përbën fitim të drejtpërdrejtë të vlerës së aktivitetit, por është pjesë e vlerës së qarkullimit. Kësaj vlere i zbriten shpenzimet për blerjen e mallrave, si dhe shpenzimet e tjera operationale, për të llogaritur fitimin. Gjatë çdo analize financiare që i bëhet veprimtarisë së një aktiviteti privat, nuk merret në konsideratë qarkullimi, por fitimi neto i realizuar dhe dokumentuar nga biznesi, sipas dokumenteve shkresore të ardhura nga Drejtoria e Tatimeve.

Pikërisht, mbi bazën e fitimit neto të realizuar dhe të dokumentuar, Komisioni ka arritur në përfundimin se të ardhurat neto të bashkëshortes së subjektit, Znj. A. T., nga aktiviteti privat, për periudhën 2003-2016, janë 12.844.341 lekë.

⁴⁴ Shiko footnote nr. 21, në këtë vendim.

⁴⁵ Shkresa nr. ***, datë 19.01.2018, e “BKT” në dosjen e Komisionit.

Sa më sipër, rezulton e vërtetuar se, në dokumentet shkresore të lëshuara nga institucionet kompetente ⁴⁶ bashkëshortja e subjektit, për periudhën 2005-2016, nuk ka deklaruar fitimet nga të ardhurat e pretenduara në raportin e auditit të pavarur, dhe si rrjedhim nuk ka paguar detyrimin tatimor për këto të ardhura.

Edhe nëse këto të ardhura do të ishin të dokumentuara nga subjekti (duke u marrë të mirëqena), do të ishim përballë faktit të fshehjes së të ardhurave, parashikuar nga neni 33, pika 5/c, i ligjit nr. 84/2016, me qëllim mospagimin e tatimit mbi të ardhurat, sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar.

Në tabelën më poshtë janë pasqyruar të gjitha të ardhurat, sipas raportit të auditit, sipas deklarimeve të subjektit dhe sipas dokumenteve të institucioneve kompetente të administruara nga Komisioni.

Vitet	Përshkrimi i veprimit	Vlerë në lekë sipas raportit të auditit	Vlera në euro sipas raportit	Vlera totale në lekë sipas raportit të auditit	Sipas deklarimit të subjektit	Sipas dokumenteve të administruara nga ana e Komisionit
2006	Të ardhurat nga “****”	3.900.000	-	1.900.000	2.000.000	480.000
2007	Të ardhurat nga “****”	3.358.000		3.358.000	1.000.000	480.000
2008	Të ardhurat nga “****”	1.580.000	-	1.580.000	1.200.000	639.000
2010	Të ardhurat nga “****”	1.650.000	-	1.580.000	1.500.000	725.653
2012	Të ardhurat nga “****”	1.800.000	-	1.580.000	1.800.000	1.145.241
2013	Të ardhurat nga “****”	1.850.000	-	1.580.000	1.003.976	1.160.210
2014	Të ardhurat nga “****”	1.700.000	-	1.700.000	1.031.254	1.164.923

Tabelë nr. 13, raportin e auditit, deklarimet e subjektit dhe dokumentet e institucioneve kompetente të administruara nga Komisioni.

Siç rezulton, të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti privat në raportin e auditit të pavarur “****” sh.p.k., janë në vlera më të mëdha se ato të deklaruara nga subjekti dhe të dokumentuara me akte shkresore nga institucionet kompetente. Për diferencat e rezultuara, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument provues.

Ne përfundim, trupa gjyquese i vlerëson si të pabazuara në prova e në ligj pretendimet e subjektit lidhur me të ardhurat e bashkëshortes në raportin e auditit të pavarur, pasi këto të ardhura janë të

⁴⁶ Shkresa nr. ***, datë 20.07.2017 dhe ***, datë 09.11.2017 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë; shkresa nr. ***, datë 09.11.2017; shkresa nr. ***, datë 02.08.2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë.

padokumentuara dhe të padeklaruara sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” të ndryshuar, dhe si të tilla nuk duhet të merren në konsideratë. Sipas ligjit të sipërpërmendur dhe nenit D, pika 4, të aneksit të Kushtetutës, të ardhura të ligjshme janë të ardhurat për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

Pas analizimit të parashtrës së subjektit, paraqitur në datën 03.04.2018, si më sipër, me vendimin nr. 3, të datës 05.04.2018, trupa gjyquese ka vendosur të ndërpresë procedurat në lidhje me vlerësimin e pasurisë, si dhe të ftojë subjektin në seancë dëgjimore në datën 11.04.2018.

V. SEANCA DËGJIMORE

Në datën 11.04.2018 u zhvillua seanca dëgjimore, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, Z. Besim Trezhnjeva.

Gjatë seancës dëgjimore, pas relatimit të çështjes nga relatorja, Znj. Firdes Shuli, përfaqësuesi i subjektit kërkoi caktimin e një eksperti ose grupi ekspertësh, me qëllim vlerësimin e pasurisë së subjektit, me arsyetimin se analiza financiare e Komisionit dhe raporti i auditit të pavarur i shoqërisë “****” sh.p.k., kanë mospërputhje thelbësore.

Me vendimin nr. 4, datë 11.04.2018, trupa gjyquese refuzoi kërkesën e subjektit për caktim ekspertësh.⁴⁷

Në vijim të seancës dëgjimore, përfaqësuesi i subjektit, avokati Fatmir Braka, paraqiti të njëjtat parashtrime, të cilat subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit, pasi atij i ka kaluar barra e provës.

Trupa gjyquese, nisur nga rezultatet e hetimit administrativ lidhur me pasurinë, vlerësoi se kriteri i pasurisë është i mjaftueshëm për procesin e vendimmarrjes lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjektit, Z. Besim Trezhnjeva, referuar nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

Për sa u përket dy kritereve të tjera, pasi janë administruar raportet për vlerësimin e figurës dhe aftësive profesionale nga organet kompetente, si dhe 11 denoncime të publikut të paraqitura pranë Komisionit në adresë të subjektit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka filluar, por nuk ka përfunduar procesin e hetimit administrativ lidhur me pastërtinë e figurës dhe aftësive profesionale për këtë subjekt.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupa gjyquese e Komisionit, pasi dëgjoji relatoren e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, dëgjoji subjektin, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, dhe pasi administroi dokumentet shpresore: Aneks 1- dosja e ILDKPKI-së; Aneks 2- dosja e Komisionit; Aneks 3- dosja e komunikimit me subjektin, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, Z. Besim Trezhnjeva, dhe shpall këtë vendim sot, në datën 13.04.2018, sipas nenit 55, pika 6, të ligjit 84/2016.

⁴⁷ Shiko vendimin nr. 4, datë 01.04.2018, të trupës gjyquese, në dosjen e Komisionit.

VI. KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR

Referuar Aneksit të Kushtetutës, neni D i saj, që parashikon “Vlerësimin e pasurive”, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me kriterin e pasurisë, trupa gjyquese konkludon se për subjektin e rivlerësimit, Z. Besim Trezhnjeva, kanë rezultuar të vërtetuara :

- deklarime të pasakta (neni 33, pika 5/a, i ligjit);
- mungesë e burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë ne shumen prej 20.133.368 lekësh (neni 33 pika 5/b, i ligjit);
- fshehje pasurie (neni 33, pika 5/c, i ligjit);
- deklarime të rreme (neni 33, pika 5/ç, i ligjit).

Bazuar në këto konkluzione, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, trupa gjyquese konkludon se subjekti i rivlerësimit,

- ➔ Ka deklarime të pamjafueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë (neni 61/3 i ligjit),
- ➔ Ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë (neni 61/5),

dhe atij duhet t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, nenet A, Ç, D, Ë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, në nenin 58, pika 1, germa “c” dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Z. Besim Trezhnjeva, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas pikës 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 13.04.2018.

Alma FASKAJ

Kryesuese

Roland ILIA

Anëtar

Firdes SHULI

Relatore

Sekretare gjyqësore

Ina Serjanaj